



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Freelance Professions  
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.22/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.148/2021, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija-Kerveshi, pala ankuuese, dhe Përmbaruesi Privat, me datë 23.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHEN** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-22/2022 i datës 04.07.2022 dhe ankesa e datës 17.06.2022 e palës ankuuese nga si të pabazuara.

**II. Përmbaruesi Privat**, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr. 148/2021.

**A r s y e t i m**

Me datën 17.06.2022 pala ankuuese, ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit, me pretendimin se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore, pasi ai si debitor asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë shkresë nga përmbaruesi, por se ka rast në përmbarim e ka kuptuar vetëm nga banka, ku ka kuptuar se ka bllokim të llogarive bankare.

Pas kësaj pala ankuese është interesuar dhe nga përmbauesi ka kuptuar se shkresat janë përcjellur përmes postës ,por që si debitor, ai nuk ka pranuar asnjëherë asnjë shkresë nga posta.

Në seancën dëgjimore,pala ankuese ka deklaruar se përmbauesi nuk ka dërguar asnjë shkresë në adresë të tij,sepse as ai si beditor e as ndonjë familjar i tij nuk ka pranuar asnjë shkresë nga përmbauesi.Për këtë i njejt i është interesuar në postë dhe nga përgjegjësi i postës ka marrë përgjigje se për datën që figuron se ai ka pranuar atë shkresë nga postieri, ai postier atë ditë ka qenë në pushim.Sikur të kishte pranuar ndonjë shkresë si debitor nuk do e linte rastin e tij një vit pa e përfunduar,por kjo ka ndodhur për shkak se përmbauesi nuk ia ka dorëzuar shkresat dhe me këtë ka bërë shkelje.

Pala ankuese si debitor,me datën 09.06.2022 përmes përmbauesit ,për lëndën përmbaimore P.nr.148/2021,ka parashtruar në gjykatë kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe ka kërkuar nga përmbauesi që pasi ka parashtruar atë kërkesë ,përmbauesi t'ia zhbllokoj llogaritë e tij si debitor,por këtë veprim përmbauesi nuk e ka ndërmarrë, ndërsa nga gjykata ende nuk ka ndonjë vendim për kërkesën e tij sa përket kthimit në gjendjen e mëparshme.

### **I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe përmbauesi të shpallet përgjegjës dhe të ndërmerren masa ndaj përmbauesit privat.**

Me datën 04.07.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë.

Përmbauesi Privat,në seancën dëgjimore ka deklaruar se pas pranimit të deshmisë së postës se është pranuar propozimi me dokumente të tjera, kanë ndërmarrë veprimet përmbaimore për bllokim të llogarive bankare të debitorit si subjekt ekonomik. Meqenëse nga bankat kishin kuptuar se nuk ka mjete në llogarinë e subjektit ekonomik-debitorit dhe se debitori ka biznes individual, i kanë dërguar kërkesë Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e ,nga ku edhe e kanë siguruar numrin personal të debitorit dhe kanë kryer bllokimin e llogarive me numër personal.Pasi nuk ka pasur në llogari mjete ,në qendrën për regjistrimin e automjeteve –ARC, e kanë bërë bllokimin e shitjes dhe regjistrimit të automjeteve të debitorit.

Pas veprimeve të tyre rreth një vit më vonë ,debitori është lajmëruar në zyre duke kërkuar shpjegime për rastin e tij. Me këtë rast, debitori kishte kërkuar debllokimin e llogarive , gjë që nuk mund të bëhej, pasi në këtë mënyrë do të kryenin shkelje, nëse do liroheshin pa ndonjë vendim të gjykatës. Me këtë rast, debitori është udhëzuar që i njejt i të drejtohet gjykatës me kërkesën për kthim ne gjendjen e mëparshme ,e nëse vendos gjykata që debitorit duhet t'i lirohen llogaritë, atëherë përmbauesi do të veproj sipas vendimit të gjykatës..

Sa i përket pretendimit se pala ankuese si debitor nuk e ka pranuar urdhërin dhe shkresat ,i njejt pretendim sipas përmbauesit, nuk qëndron sepse ,përpos fotokopjes për dorëzimin e shkresave nga zyrtarët e postës i njejt ka kërkuar edhe vërtetimin me shkrim dhe me dt.12.09.2022 , ka pranuar vërtetimin nga Posta e Kosovës ,ku dëshmohet se dërgesa në fjalë është dorëzuar me dt,18.06.2022 sipas librit të postierit e dëshmuar edhe me deklaratën e tij të dt.02.06.2022.

Më tutje, përmbauesi privat ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese edhe për faktin se gjykata ende nuk ka vendos lidhur me kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme . Andaj ka kërkuar nga komisioni që mos të vendos fare lidhur me këtë rast dhe të pritët vendimi i gjykatës lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme.

Në seancë ,komisionit si provë ia dorëzoi librin e dorëzimit të datës dt.18.09.2022 dhe vërtetimin e pranimit nga posta të librit të dorëzimit të postës ,që në zyre të përmbauesit, është pranuar me datën 15.07.2022.

I ka propozuar komisionit që ankesa ankesa e palës ankuese të refuzohet, pasi ai e ka bërë dorëzimin e shkresave në mënyrë të rregullt.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbauesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërin nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së,

Këtë konstatim komisioni e bazon në provat e ofruara nga përmbauesi privat,ku vërtetohet se përmes postës është pranuar urdhëri i përmbauesit privat,gjë që provohet me dëshminë e Postës së Kosovës,ku shihet se në librin e postës ekziston nënshkrim i debitorit dhe këtë e ka vërtetuar përmes kërkesës së përmbauesit drejtuar postës,pasi fletëkthesa e përmbauesit , nuk i është kthyer nga posta.

Pretendimi i debitorit se postieri që figuron në atë libër në datën e cekur ka qenë në pushim e ai dhe as familjarët e tij nuk kanë pranuar asnjë shkresë,nuk qëndron,sepse nuk është përgjegjësi e përmbauesit të verifikoj se kush e ka dorëzuar nga posta shkresën, përpos të evidentoj se shkresat përmes postës janë pranuar nga debitori,që vërtetohet më nënshkrimin e dhënë në librin e postës.

Sa i përket kërkesës së palës ankuese që përmes komisionit të kërkohet që përmbauesi të liroi llogaritë e debitorit si dhe kërkesa e përmbauesit që vendimi i komisionit të shtyhet deri në vendimin e gjykatës,të njejtat nuk janë trajtuar nga komisioni,pasi komisioni është i pavarur dhe vendos në bazë të provave të ofruara mbi shkeljet e pretenduara si dhe nuk ka kompetencë të urdhëroj përmbauesin për ndërmarrjen e veprimeve apo jo,por vetëm të konstatoi përgjegjësinë eventuale dhe se a janë ndërmarrë veprimet bazuar në dispozitat ligjore që e obligojnë organin përmbauesor.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**

**DPL.nr.22/2022 datë 23.09.2022**

**Kryesuesja e Komisionit Disiplinor**

Manushe Karaçi



***KËSHILLË JURIDIKE:Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.***